



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 4, datë 31.01.2022


**Për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “g” dhe nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “q” dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “f” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në aneksin 1 “Struktura organizative”, si dhe në aneksin 2 “Organika” bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) suprimohet pozicioni i punës “Kordinator për marrëdhëniet me GKSF dhe institucionet ndërkombëtare dhe Sekretar i Këshillit Drejtues”;
  - b) emërtesa e pozicionit të punës “Asistent Ligjor dhe Administrativ i Drejtorit të Përgjithshëm” bëhet “Asistent Ligjor dhe Administrativ i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Sekretar i Këshillit Drejtues”.



## KËSHILLI DREJTUES

2. Në aneksin 2 “Organika”, bashkëlidhur vendimit bëhet ndryshimi i mëposhtëm:
  - a) përshkrimi i punës për pozicionin “Asistent Ligjor dhe Administrativ i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Sekretar i Këshillit Drejtues”, zëvendësohet me tekstin e aneksit bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Numri i punëmarrësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave bëhet 29 gjithsej.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi  
**Sekretare**

Donald Duraj  
**Kryetar**